


EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5763
E shtunë, 27 prill 2019
çmimi 0.40 €

Sfida e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut

IFAQE 11

Bedri
ISLAMI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU

IFAQE 4-5

Do të organizojmë edhe protesta të tjera derisa ta rrëzojmë qeverinë

Nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, ka bërë me dije se protestat do të vazhdojnë deri në rrëzimin e qeverisë. Për këtë ajo ka thënë se bashkëpunimi opozitar është i logjikshëm dhe i pritshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mulhaxha-Kollçaku ka vlerësuar se PAN-i ka për qëllim interesat partiake e jo ato shtetërore. Ajo ka deklaruar se ky koalicion nuk ka marrë vendime pozitive për vendin prandaj, sipas saj, zgjedhjet e parakohshme janë e vetmja zgjidhje. Deputetja Mulhaxha-Kollçaku ka thënë se pakënaqësia qytetare është rritur sa i përket mungesës së rendit dhe ligjit. Ajo ka vlerësuar se pa i luftuar krimin dhe korrupsionin nuk ka ecje përpara



U BËNË TRI VJET NGA VDEKJA E VEPRIMTARIT TË ÇËSHTJES KOMBËTARE,
SHASIVAR MAKOLLI-QALI

IFAQE 3

Shasivar Makolli-Qali nderohet me 'Urdhrin e Lirisë'



Në trevjetorin e ndarjes nga jeta të veprimtarit të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli-Qali, të premtën është bërë zbulimi i pllakës përkujtimore për të si dhe është mbajtur akademi përkuj-

timore në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Ndërkaq presidenti Hashim Thaçi i ka ndarë "Urdhrin e Lirisë". Qali në akademinë

përkujtimore u vlerësua si personalitet që e donte atdheun pa kushte, si njeri trim, fisnik dhe humanist, që tërë jetën ia kushtoi çështjes kombëtare dhe çlirimit të Kosovës

AKTUALE



THAÇI 'PËRPLASET' ME ANËTARËT E KOMISIONIT HETIMOR, SHKAK RASTI I 'GULENISTËVE' F. 6

KDI-ja KËRKON QË KOSOVA TË PREZANTOHET ME ZË UNIK NË SAMITIN E BERLINIT F. 6

QEVERIA NDAN 1 MILION EURO PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET NË RAHOVEC F. 7

EKONOMI

BQK-ja REVOKON LICENCËN E KOMPANISË SË SIGURIMEVE 'INSIG' F. 9

PËRUROHET SHIRITI RRUGOR SHITESË NË PIKËN DOGANORE TË MORINËS F. 9

EKONOMI

KOSOVA KA SHËNUAR HAPA KONKRETË NË FUSHËN E TË DREJTËS SË AUTORIT F. 11

SPORT

ORARI I NDESHJEVE TË JAVËS SË 29 NË IPKO SUPERLIGË F. 18

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Hahn, optimist për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut

BRUKSEL, 26 PRILL - Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut ka të ngjarë ta sigurojnë rekomandimin pozitiv nga Komisioni Evropian për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit, tha komisionari për Zgjerim i BE-së, Johannes Hahn, për DPA-në. Ai tha se "është i bindur" se Komisioni do ta lëshojë këtë rekomandim

në fund të majit. Hahn lavdëroi në veçanti Maqedoninë e Veriut për zgjidhjen e kontestit të emrit me Greqinë. Shtetet e BE-së kanë rënë dakord në parim në qershorin e kaluar, por fillimi formal i bisedimeve varet nga reformat e mëtejshme. Komisioni do të dalë me një përditësim rreth përpjekjeve për reforma pas

zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, në fund të majit. Hahn po ashtu i paralajmëroi shtetet anëtare që "të mos luajnë për të blerë kohë". "Vetëm politikë e besueshme do të kenë sukses në nxitjen e procesit reformues të Ballkanit Perëndimor dhe në ruajtjen e ndikimit tonë në rajon", tha Hahn.



Kandidatët për president, me retorikë të matur para shqiptarëve

Në tubimet me elektoratin në Maqedoninë e Veriut, por edhe në paraqitje të ndryshme para mediave për herë të parë, kandidatja e opozitës, Gordana Siljanovska-Davkova, si dhe partia që e ka dominuar, VMRO DPMNE-ja, kanë ndryshuar retorikën nga ciklet e kaluara zgjedhore, duke ftuar shqiptarët që të votojnë për të në raundin e dytë më 5 maj

SHKUP, 26 PRILL - Dy kandidatët për president të Maqedonisë së Veriut që kaluan në balotazhin që do të mbahet më 5 maj, në tubimet me elektoratin janë përqendruar edhe në votat e shqiptarëve, të cilat besohet se janë vendimtare duke marrë parasysh rezultatet thuajse të barabarta, por edhe rreth 80 mijë votat që mori në raundin e parë kandidati shqiptar Blerim Reka. Në tubimet me elektoratin, por edhe në paraqitje të ndryshme para mediave për herë të parë, kandidatja e opozitës Gordana Siljanovska-Davkova, si dhe partia që e ka dominuar, VMRO DPMNE-ja, kanë ndryshuar retorikën nga ciklet e kaluara zgjedhore, duke ftuar shqiptarët që të votojnë për të në raundin e dytë më 5 maj. Siljanovska, ndërkohë, i ka quajtur të palogjikshme dhe tendencioze deklaratat e zyrtarëve të LSDM-së, se ajo është albanofobe dhe se nuk duhet të llogarisë në votat e shqiptarëve. "Mund të dëgjojmë deklaratat tragjikomike se gjoja unë kam qenë albanofobe. Kjo

është jashtë logjikës së shëndoshë, dhe jo vetëm nga realiteti. Albanofobia është sjellje jonjerëzore. Unë asnjëherë nuk kam bërë diçka të tillë në jetën time. Që nga fëmijëria jam shoqëruar me shqiptarë dhe mund të numëroj shumë shembuj të bashkëjetesës. Nga ta kam mësuar se çfarë është Besa, fjalë e dhënë e shumë gjera të tjera të mira", ka deklaruar Siljanovska. Ajo ka theksuar se në fjalimet e saj në tubimet me elektoratin asnjëherë nuk ka përcuar urrejtje mes bashkësive, përkundrazi u është drejtuar të gjithë qytetarëve ashtu siç do t'u drejtohet deri në fund të fushatës zgjedhore. "Unë në të gjitha deklaratat e mia u drejtohem të gjithë qytetarëve. Është e qartë se qytetarët e bashkësisë etnike shqiptare janë në numër imponant të trupit votues. Ashtu sikur Blerim Reka, edhe unë u drejtohem të gjithë individëve gjatë paraqitjeve të mia, nuk përfaqësoj parti politike pasi jam kandidatë e pavarur. Unë u garantoj të gjithëve se, nëse



zgjedhem presidente, do të punoj për të gjithë njësoj, si për maqedonasit, ashtu edhe për shqiptarët, turqit, serbët, romët, boshnjakët e bashkësitë e tjera etnike", ka theksuar Siljanovska. Edhe VMRO-ja, e cila në vazhdimësi ka kundërshtuar të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me avancimin e pozitës juridike të shqiptarëve në shtet, si Ligjin për Gjuhën, për simbolet kombëtare e çështje të tjera, ka kërkuar mbështetje në raundit e dytë. Edhe kandidati i social-demokratëve, Stevo Pendarovski, që ka mbështetur edhe të 31 partive politike, sikur në raundin e parë, edhe tani ka bërë thirrje për zgjedhjen e një presidenti me mbështetjen e të gjitha partive

politike, ka raportuar rfe. "Dua t'u drejtohem edhe të gjithë atyre që votuan për Blerim Rekën. Pres mbështetjen e tyre në raundin e dytë, për ta çuar para Maqedoninë e Veriut, konceptin tonë 'një shoqëri për të gjithë', për ta bërë vendin, shtet të të gjitha bashkësive etnike dhe jo për ta kthyer në izolim dhe pa perspektivë", është shprehur Pendarovski. Lidhja Social-Demokrate që drejtohet nga kryeministri Zoran Zaev është e para e cila që para dy vjetësh, por edhe më herët kur ishte në opozitë, ka dalë me konceptin "Maqedonia për të gjithë", për çka edhe ka marrë shumë vota të shqiptarëve, ndërsa në Kuvend dhe Qeveri është e përfaqësuar me deputetë dhe ministra shqip-

tarë. "Unë e di se në rrethin e dytë qytetarët edhe më fuqishëm do ta mbështesin përparimin, do ta mbështesin konceptin tonë që në këtë shtet të gjithë të jenë të barabartë pasi vetëm kështu vendi ynë mund të ketë perspektivë, zhvillim dhe mund të bëhet pjesë e familjes evropiane", ka deklaruar Zaev. Dallimi mes dy kandidatëve në rrethin e dytë ka qenë 4500 vota në favor të kandidatit të social-demokratëve, Stevo Pendarovski, por mosdalja eventuale e votuesve të kandidatit shqiptar mund të rrezikojë arritjen e pragut zgjedhor prej 40 përqindësh pasi në raundin e parë në zgjedhje kanë dalë 41.79 për qind nga 1.8 milion qytetarë me të drejtë vote.

Opozita bllokoi rrugët në gjithë Shqipërinë

TIRANË, 26 PRILL - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka mbledhur të premten në një takim, në selinë e partisë, gjithë kryetarët e PD-së në rrethe. Në qendër të takimit ka qenë diskutimi për krizën politike dhe aksioni i opozitës kundër qeverisë "Rama". Burime nga PD-ja bëjnë me

dije se në takim është vendosur që çdo të enjte të ketë bllokim rrugësh si shenjë e mosbindjes civile ndaj qeverisë "Rama". Basha ka kërkuar nga drejtuesit e PD-së që t'i shtojnë takimet me qytetarët ku të shpjegohet qëndrimi i opozitës dhe vendimi për bojkotin e zgjedhjeve lokale të 30 qershorit. Një ditë më parë opozita shpal-

li nisjen e mosbindjes civile, ku përgjatë një ore u bllokuan pesë akset kryesore rrugore në vend. Vendimi i PD-së vjen pas një klime të tensionuar politike me protesta dhe reagim të fortë policor nga ana e qeverisë. Opozita ka shpallur objektivat për qeveri tranzitore dhe zgjedhje normale pas largimit të kryeministrit Edi Rama.



U bënë tri vjet nga vdekja e veprimtarit të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli-Qali

Shasivar Makolli-Qali nderohet me 'Urdhrin e Lirisë'

Në trevjetorin e ndarjes nga jeta të veprimtarit të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli-Qali, të premten është bërë zbulimi i pllakës përkujtimore për të si dhe është mbajtur akademi përkujtimore në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Ndërkaq presidenti Hashim Thaçi i ka ndarë "Urdhrin e Lirisë". Qali në akademinë përkujtimore u vlerësua si personalitet që e donte atdheun pa kushte, si njeri trim, fisnik dhe humanist, që tërë jetën ia kushtoi çështjes kombëtare dhe çlirimit të Kosovës

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 PRILL - Në trevjetorin e ndarjes nga jeta të veprimtarit të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli-Qali, të premten është bërë zbulimi i pllakës përkujtimore për të. Në zbulimin e kësaj pllake dhe në trevjetorin e ndarjes nga jeta të Shasivar Makolli-Qali morën pjesë bashkëveprimtarë të tij të çështjes kombëtare, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të OVLUÇK-së, miq dhe familjarë. Bashkëveprimtari i Shasivar Makollit, Bardhyl Mahmuti, ka thënë se sot po përkujtojmë njërën nga veprimtarët më të mëdhenj të çështjes kombëtare. Ai ka thënë se sa herë është folur për çështjen

kombëtare, Shasivar Makolli-Qali ka qenë aty. "Më lejoni që fillimisht të përshëndes djalin e bacës Adem, Shqiptar Demaçi, i cili është i pranishëm sot në këtë përvjetor. Shasivar Makolli ka qenë krah i djathtë i bacës Adem që prej kohësh kur është njohur me të. Sot jemi në trevjetorin e ndarjes fizike nga ne të Shasivar Makollit dhe vazhdimin në përjetësi të njërit nga veprimtarët më të mëdhenj të çështjes kombëtare. Sa herë është folur për çështjen kombëtare në prani të Shasivar Makollit, siç thotë populli 'mate veten', Shasivar Makollin e ke pasur aty qoftë për çështjen për shqiptarët në Kosovë, qoftë në atë pjesën e Kosovës me kryeqendër Shkupin që mbeti në Maqedoni, qoftë në të gjitha viset

ku është folur shqip, Shasivar Makolli ka qenë një shtyllë e fuqishme dhe mbështetëse për të gjithë veprimtarët të cilët kanë qenë të rrezikuar", ka thënë Bardhyl Mahmuti.

Ish i burgosuri politik, Barjush Xhemajli, në fjalën e tij ka thënë se ka pasur nderin që ta njohë Shasivar Makollin. Xhemajli ka thënë se Shasivar Makolli ka qenë vazhdues i denjë i shqiptarëve jo vetëm në Kosovë. "Kam pasur nderin që ta njoh bacën Shasivar. Brezit të tij i ka rënë një barrë e rëndë gjatë historisë. Te bacë Shasivar që në fillim ke mundur ta vëshesh se mund të kesh besim tek ai. Ai i ka bërë njerëzit jo vetëm që ta duan, por edhe t'i bashkëngjiten veprimtarisë së tij. Është vështirë që një familje ta mbajë brez pas brezi flakën e lirisë gjithmonë ndezur. Baca Shasivar ka qenë vazhdues i denjë i shqiptarëve jo vetëm në Kosovë", ka thënë Bajrush Xhemajli.

Zbulimin e pllakës përkujtimore të Shasivar Makollit-Qalit e bënë: Çlirim Haziri, Shqiptar Demaçi, Shaban Muja, Sylejman Krasniqi, Bardhyl Mahmuti, Muhamet Mavraj, Ardian Mehani, Xhelal Pakashtica dhe Fatmir Arifi.



Shasivar Makolli jetën ia kushtoi kombit shqiptar

Në trevjetorin e ndarjes nga jeta të veprimtarit të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli-Qali, presidenti Hashim Thaçi i ka ndarë "Urdhrin e Lirisë". Ndërkaq Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, e cila edhe ka organizuar sot akademi përkujtimore për Qalin, ka ndarë mirënjohje për veprimtarinë e tij në shërbim të çështjes kombëtare dhe luftës për liri. Këtë mirënjohje e ka pranuar vajza e Shasivar Makollit, Merita.

Në këtë akademi përkujtimore për Qalin, e cila u mbajt në Teatrin Kombëtar në Prishtinë, mori pjesë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, gjeneral Kudusi Lame, ish-drejtuari i Lëvizjes Studentore të '97-s, Driton Lajçi, përfaqësues të OVLUÇK-së, ministra, deputetë, përfaqësues partish, bashkëveprimtarë të Qalit dhe familjarë.

Në fjalën e tij, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se veprimtaria kombëtare e Shasivar Makollit i ka bashkuar sot në këtë akademi përkujtimore. Ai ka thënë se Shasivar Makolli ka qenë pjesëmarrës i të gjitha organizimeve kombëtare, raporton "Epoka e re".

Veseli ka thënë se Qali hynë në kategorinë e atyre që e duan atdheun pa kushte. "Përherë do ta kujtojmë Qalin", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, ka përgëzuar veteranët për orga-

nizmin e kësaj akademie për Qalin. "Përgëzoj veteranët që nuk i harrojnë veteranët dhe luftëtarët. Shasivari e ka pasur pikën më të dobët bacën Adem Demaçi sepse ai është përkujdesur për çdo lëvizje të tij. Shasivar Makolli ishte pjesë e pandarë e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Lavdi Shasivarit dhe heronjve të luftërave", ka thënë Ahmeti.

Ish-drejtuari i Lëvizjes Studentore të '97-s, Driton Lajçi, ka thënë se atdheu ynë ka pasur gjithmonë heronj të heshtur dhe një ndër ta ishte edhe Shasivar Makolli. Lajçi ka treguar se Qalin e kanë pasur krah të fortë gjatë aktiviteteve të Lëvizjes Studentore. "Ai e bënte gjithnjë punën e vet me trimëri, fisnikëri dhe humanizëm. Kështu kishin bërë edhe të parët e tij. Ai dhe shtëpia e tij ka qenë derë e lëvizjes kombëtare brez pas brezi. Strehues, mbrojtës dhe shoqëruar i plotë figurave e drejtuesve të kombit", ka thënë Lajçi, i cili ka treguar edhe çaste me tij, kur kishte udhëtuar së bashku me Qalin për të marrë pjesë në takime të ndryshme jashtë vendit. "Pa këta heronj Lëvizja Studentore s'do të bëhej ajo që u bë, sikurse edhe lufta çlirimtare për liri nuk do të ishte aq e suksesshme. Të tillë na duhen edhe sot, por në kontekstin e kohës. Prandaj në emër të gjeneratës sime dhe Lëvizjes Studentore, qoftë i përherëshëm kujtimi për Shasivar Makollin! Të faleminderit, Qali!

Gjenerali Kudusi Lame ka thënë se Shasivar Makolli ka luajtur rolin

kombëtar me mjeshtëri. Lame ka treguar se Shasivar Makolli asnjëherë nuk ka rrahur gjoks për çfarëdo aktiviteti madhor që ka bërë për kombin. "Ishte gjithnjë në rrjedhjen e vullshme madhore. Pa bërë deklarata se unë e organizova ose unë dola në ballë. Shasivar Makolli ka punuar pa reshtur. Tërë jetën ia ka kushtuar kombit shqiptar", ka thënë gjenerali Lame. Ai ka shtuar se jorastësisht ndodhej afër fuqisë kombëtare, Adem Demaçi. "Shasivar Makolli bënte vepra të mëdha. Do të mbetet shembull se për kombin duhet punuar gjithnjë", ka thënë Kudusi Lame.

Nënkryetari i OVLUÇK-së, Migjen Shala, në fjalën e tij ka thënë se Shasivar Makolli asnjëherë nuk u ndal së vepruari për lirinë e Kosovës. Ai ka thënë se shtëpia e Shasivar Makollit ishte vend për çështjen kombëtare. "Vepra e tij do të kujtohet gjithnjë. Ju familje, të jeni krenarë për të", ka thënë Shala. Të pranishmit në këtë akademi i ka përshëndetur vajza e Shasivar Makollit, Merita, e cila ka thënë se është krenari të shohë kaq burra të mëdhenj të kombit në këtë sallë të vogël. Ajo tregoi edhe një rast kur babai i saj vinte nga udhëtimi prej Shqipërisë. "Kur kthehej nga Shqipëria u merrnim erë robave dhe trupit të tij, sepse e ndjenim erën e Shqipërisë. Unë sot këtu uroj që brezat e ardhshëm, fëmijët tanë, të rriten me atë aromë të ëmbël që e kemi ndier në rrobat e babës tonë", ka thënë Merita Shasivari, vajza e Qalit.



Flet për "Epokën e re", Fatmire Mulhaxha-Kollçaku

Do të organizojmë edhe protesta të

Nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, ka bërë me dije se protestat do të vazhdojnë deri në rrëzimin e qeverisë. Për këtë ajo ka thënë se bashkëpunimi opozitar është i logjikshëm dhe i pritshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mulhaxha-Kollçaku ka vlerësuar se PAN-i ka për qëllim interesat partiake e jo ato shtetërore. Ajo ka deklaruar se ky koalicion nuk ka marrë vendime pozitive për vendin prandaj, sipas saj, zgjedhjet e parakohshme janë e vetmja zgjidhje. Deputetja Mulhaxha-Kollçaku ka thënë se pakënaqësia qytetare është rritur sa i përket mungesës së rendit dhe ligjit. Ajo ka vlerësuar se pa i luftuar krimin dhe korrupsionin nuk ka ecje përpara

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 PRILL -

"Epoka e re": Znj. Mulhaxha-Kollçaku, të premtën Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur një protestë para zyrës së kryeprokurorit të shtetit. Është kërkuar largimi i tij. Prisni rezultate nga kjo protestë?

Mulhaxha-Kollçaku: Presim reflektim nga kryeprokurori dhe gjyqtarët për ta kryer detyrën për çfarë janë të thirrur. Duhet të ketë guxim një njeri që e merr postin e kryeprokurorit, dhe ky guxim nuk duhet të humbet në gjysmë të rrugës. Deri më tash Lëvizja Vetëvendosje i ka denoncuar shumë herë krimin dhe korrupsionin institucional. Këtë e kemi bërë kryesisht në seanca parlamentare. Do të thotë, veprimin tonë opozitar e kemi

kryer aty ku është vendi, në Kuvendin e Kosovës. Janë bërë shumë shkelje të mëdha, sidomos prej zyrtarëve të profilit të lartë shtetëror, por askush nuk është marrë me ta. Janë 70 raste të hapura për zyrtarë të lartë, por deri më tani nuk ka asnjë dënim. Ky jo vetëm se ka qenë kushti për liberalizimin e vizave, por do të vazhdojë të jetë edhe kushti për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Nuk synojmë ta marrim drejtësinë në duart e tona, por po bëjmë presion publik që prokuroria dhe gjyqësori t'i ndjekin dhe t'i përfundojnë këto raste, sepse pa e luftuar krimin dhe korrupsionin nuk ka ecje përpara. Ata që nuk janë të gatshëm për ta kryer detyrën duhet t'ua lëshojnë vendin të tjerëve të cilët kanë guxim dhe vullnet për të punuar dhe për ta luftuar krimin e organizuar dhe

korupsionin. Protesta e së premtës ka qenë reagim qytetar, sepse jo vetëm Lëvizja Vetëvendosje është e pakënaqur me gjendjen e përgjithshme në Kosovë, në veçanti me sistemin e drejtësisë.

"Epoka e re": Për këtë çështje dhe për të tjera, a do të vazhdojnë protestat?

Mulhaxha-Kollçaku: Kjo protestë nuk ka qenë e para dhe nuk do të jetë as e fundit. Aktiviteti opozitar po vazhdon edhe në tubimet me qytetarë nëpër komuna. Aty po shohim pakënaqësinë e madhe të qytetarëve me krejt sistemin, në veçanti me mungesën e sundimit të rendit dhe ligjit. Do të kemi edhe protesta të tjera deri në rrëzimin e kësaj qeverie dhe krejt kjo është në funksion të përmirësimit të situatës në Kosovë. Por, megjithatë, mendojmë se zgjidhja e fundit

janë zgjedhjet. Deri në zgjedhjet e parakohshme demokratike do të vazhdojë agonia. Sikur të kishin ndërgjegje këta pushtetarë vetë do të jepnin dorëheqje. Disa prej tyre do të kenë mundësi të shkojnë në shtëpi, por shumë prej tyre do të përgjigjen para organeve të drejtësisë.

"Epoka e re": Meqë po thoni se zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje, për ta arritur këtë qëllim jeni duke bashkëpunuar me LDK-në?

Mulhaxha-Kollçaku: Një bashkëpunim opozitar është edhe i logjikshëm, edhe i pritshëm. Shumë simpatizantë, aktivistë dhe udhëheqës të LDK-së, janë të pakënaqur me gjendjen aktuale. Do të bëjmë përpjekje që në vazhdimësi për çështjet që janë në interes të qytetarëve dhe të Kosovës t'i bashkërendojmë

aktivitetet. Vetëvendosja ka treguar dhe tregon vullnet për bashkëpunim opozitar.

"Epoka e re": Por në protestën e së premtës nuk mori pjesë LDK-ja.

Mulhaxha-Kollçaku: Protestat tona edhe në të kaluarën nuk janë lidhur me subjektet politike me çdo kusht por, nëse i kanë mbështetur dhe u janë bashkangjitur, i kemi mirëpritur. Tani për tani kemi vetëm një koalicion dhe ai është me qytetarët. Ne do të vazhdojmë të angazhohemi për kauza të drejta.

"Epoka e re": Në kuadër të këtij bashkëpunimi në mes të Vetëvendosjes dhe LDK-së, a mund të pritet ndonjë iniciativë konkrete për rrëzimin e qeverisë qoftë me mocion në Kuvend,

tjera derisa ta rrëzojmë qeverinë

ne, por të gjithë qytetarët e Kosovës kanë parë se nga ky koalicion nuk ka ardhur asnjë vendim pozitiv për vendin. Ata ia kanë rritur pagat vetes, e kanë rritur numrin e zëvendësministrave, këshilltarëve, kanë punësuar familjarë, militantë partiakë, kanë keqpërdorur 53 milionë euro si dhe kanë ndërmarrë edhe një serë vendimesh të dëmshme. Këta zbatojnë ligjin vetëm ku iu konvenon. Autostrada për Dukagjin më shumë i ngjan një afere korruptive sesa një projekti që është në të mirën e qytetarëve aktualisht. Papunësia dhe varfëria janë në rritje, nuk ka përmirësim të mirëqenies së qytetarëve, por ka vetëm përmirësim të mirëqenies së pushtetarëve.

"Epoka e re": Përballë kësaj qeverisje opozita a po e luan rolin që i takon?

Mulhaxha-Kollçaku: Kushdo që jeton në Kosovë e sheh angazhimin në veçanti të deputetëve dhe të aktivistëve të Vetëvendosjes. Nuk ka ditë që nuk kemi denoncuar ndonjë dukuri negative në shoqëri qoftë përmes seancave të jashtëzakonshme në Kuvend, debateve të ndryshme dhe formave të tjera qoftë vetëm si Vetëvendosje apo edhe me LDK-në. Kemi ngritur pa numër çështje dhe kemi denoncuar pa numër parregullsi. Mirëpo e gjithë kjo ka hasur në veshët e shurdhër të pushtetarëve të etur për pushtet të cilët tashmë e kanë humbur rrugën në oborr. Të njëjtit njerëz që e kanë kundërshtuar demarkacionin me Malin e Zi më vonë e nënshkruan atë. Premtuan korrigjim, por në këtë drejtim ende nuk ka asnjë lëvizje. Në anën tjetër presidenti është angazhuar për pazare me Serbinë, përkatësisht për shkëmbim të territoreve pa pasur autorizimin e Kuvendit dhe Kushtetutës.

qoftë me protesta në rrugë?

Mulhaxha-Kollçaku: Në momentin që do t'i kemi votat e mjaftueshme do ta iniciojmë edhe mocionin ndaj qeverisë, mirëpo aktualisht si opozitë nuk i kemi numrat për ta bërë një gjë të tillë. Presim reflektim të deputetëve të tjerë të cilët nuk janë të kënaqur dhe të tillë ka edhe në mesin e partive në pushtet. Këta pushtetarë edhe në të kaluarën kanë dëshmuar se kur u janë prishur pazaret e kanë rrëzuar vetveten. PAN koalicioni është një krijesë artificiale me shumë subjekte politike që ka për qëllim interesat personale dhe partiake, e jo interesat shtetërore.

"Epoka e re": Si e keni parë qeverisjen e deritanishme të këtij koalicioni qeverisës?

Mulhaxha-Kollçaku: Jo vetëm

borxh. Serbia nuk ka kërkuar falje. Ende nuk e pranon krimin dhe gjenocidin që ka bërë në Kosovë. Përkundrazi, po e luan rolin e viktimës, edhe pse botërisht dihet se e ka pasur rolin e xhelatit. Kosova duhet t'i tregojë botës se ka qenë viktimë. Në këtë dialog duhet të kemi pozicion të barabartë. Dhe duhet të kërkojmë që Serbia t'i paguajë dëmet e luftës në Kosovë.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet e Vetëvendosjes nga Samiti i Berlinit dhe a besoni në arritjen

e marrëveshjes përfundimtare për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë? **Mulhaxha-Kollçaku:** Sa do që ka qëllime të mira nga miqtë tanë, Serbia çdo ditë po jep prova se nuk është e gatshme për një marrëveshje përfundimtare. Nuk ka ende ndryshim substancial në Serbi. Derisa kemi një Serbi që nuk është ballafaquar me të kaluarën është shumë vështirë të ketë një marrëveshje përfundimtare për normalizim. Ne e mirëpresim angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare dhe

të miqve tanë që gjatë gjithë historisë na kanë ndihmuar, por mendojmë se presion duhet bërë Serbisë. Kosova meriton që t'i përshpejtohen proceset integruese. Serbia historikisht ka nxitur luftëra, kurse Kosova është mbrojtur. Ende janë të pakta gjasat për marrëveshje të pajtimit. Dialogut duhet të rifillojë për së mbari, me një qeveri të re e cila do ta përfaqësojë shtetin sovran dhe nuk ka për çka të turpërohet por, përkundrazi, do të kërkojë nga Serbia të paguajë ato që i ka bërë në Kosovë.

Vetëvendosja protestoi kundër kryeprokurorit Lumezi

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka organizuar të premtën një protestë në Prishtinë kundër kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, dhe korrupsionit në rritje në Kosovë. Protesta ka nisur simbolikisht pesë minuta para orës 12:00 para ndërtesës ku ndodhet Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në rrugën "Luan Haradinaj" në Prishtinë. Fillimisht protestuesit kanë brohoritur: "Me hajna nuk ka shtet", "Lumez ik, duam Republikë", ndërsa në pankartat që protestuesit mbanin në duar shkruante: "Po drejtësisë, jo korrupsionit".

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, e cila ka folur para masës, ka

thënë se protestat do të vazhdojnë dhe do të jenë paqësore. Haxhiu ka kërkuar ndryshime në prokurori, duke larguar, siç ka thënë ajo, të gjithë prokurorët që janë emëruar politikisht. "Ne në javët e muajt në vazhdim nuk do të ndalemi derisa ta largojmë PAN-hajninë, këta që i kemi parasysht e që po bëhen kinse nuk po shohin. Nuk ka më kohë për prokurorinë e pushtetit, nuk ka më kohë as për pushtetin e hajnisë, ka ardhur koha për drejtësi e jo drejtësi për interes. Ka ardhur koha për ndryshim, e ndryshimi jemi ne, jeni ju, janë qytetarët e Kosovës", ka deklaruar Haxhiu. Në protestë është thënë se në Kosovë nuk mund të ketë luftim të krimit të organizuar dhe të

korrupsionit të institucionalizuar derisa nuk ka gjyqësor të drejtë.

Kritikët kanë thënë se Lumezi dyshohet se është i korruptuar dhe i lidhur me pushtetin.

Pas kësaj proteste, lideri i Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se kjo ka qenë një protestë e ndërmjetme në kuadër të fushatës kundër PAN-hajnisë. "Protestat e tjera do të vijnë në sheshin 'Skënderbe' kundër PAN-hajnisë. E kemi pasur të domosdoshme që një protestë ta bëjmë këtu para zyrës së kryeprokurorit për shkak të heshtjes së tij, për shkak se iu bashkëngjiti kryeministrit atëherë kur u ndoq Elez Blakaj, e kështu me radhë", ka thënë Kurti.



Thaçi 'përplasat' me anëtarët e Komisionit Hetimor, shkak rasti i 'gulenistëve'

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të premten i është përgjigjur pozitivisht ftesës së Komisionit Hetimor Parlamentar për deportimin e gjashtë shtetasve turq. Me të filluar ky takim ka pasur përplasje verbale në mes të presidentit Thaçi dhe kryetarit të këtij komisioni, Xhelal Sveçla. Fillimisht Thaçi ka kërkuar të dijë se cila është baza ligjore e marrjes në pyetje dhe cili është eksperti që e ka përpiluar raportin për rastin e "gulenistëve". Në këtë kontekst, Thaçi ka thënë se nuk është e udhës të mos dihet se kush është eksperti ndërkombëtar i angazhuar për këtë çështje. Po ashtu, presidenti Thaçi ka pyetur se me çfarë baze ligjore është angazhuar eksperti ndërkombëtar për rastin në fjalë.

Ndërsa anëtari i Komisionit Hetimor nga AAK-ja, Muharrem Nitaj, ka thënë se nuk është kërkuar interpretim nga ndonjë zyrë ligjore lidhur me angazhimin e këtij eksperti. Ai ka kërkuar nga Thaçi që nëse ka ndonjë informacion që mund ta komprometojnë angazhimin e këtij eksperti, atëherë t'i tregojë komisionit. Megjithatë, kryetari i komisionit, Sveçla, ka thënë se eksperti është angazhuar në konsultim me juristët e komisionit dhe sekretarinë e Kuvendit, por një gjë e tillë nuk e ka bindur Thaçin, i cili ka thënë se eksperti ndërkombëtar ka punuar me Sami Kurteshin sa ka qenë Avokat i Popullit. Dhe,



rrjedhimisht, Thaçi ka thënë se nuk mund ta flasë për rastin e "gulenistëve" pa pasur një interpretim ligjor për shkak të temave që prekin çështjet e sigurisë kombëtare.

Ndërsa anëtari tjetër i këtij komisioni nga PDK-ja, Hajdar Beqa, ka thënë se askush nuk ka pasur informacione për ekspertin e angazhuar. Ai ka thënë se krejt çfarë di për të është se i njëjti ka punuar në Zyrën e Avokatit të Popullit. Megjithatë anëtarët e Komisionit Hetimor kanë kërkuar përgjigje nga presidenti për angazhimin e tij në rastin e "gulenistëve", Thaçi ka thënë se ai duhet të dijë fillimisht se në çfarë forme është angazhuar eksperti i apostrofuar. Më tutje, anëtari tjetër i Komisionit Hetimor nga PSD-ja, Frashër

Krasniqi, ka thënë se Thaçi po përdor strategji për të mos iu përgjigjur pyetjeve, por për t'u bërë pyetje anëtarëve të këtij komisioni. Ai e ka pyetur Thaçin nëse e ka telefonuar homologu i tij turk, Rexhep Taip Erdogan, për t'i deportuar gjashtë "gulenistët" për në Turqi.

Debatit rreth kësaj teme është nxehur më shumë kur Sami Kurteshi ka thënë se Thaçi ka skenar për ta prishur mbledhjen e Komisionit Hetimor. Pavarësisht kësaj, Kurteshi e ka pranuar se ai vetë e ka propozuar ekspertin dhe i njëjti është votuar nga anëtarët e këtij komisioni. Gjatë kësaj mbledhje është zhvilluar një debat i ashpër në mes të Kurteshit dhe Thaçit, ku ky i fundit i ka dhënë deputetit të Vetëvendosjes se e ka lutur në

zyrën e tij, sa ishte kryeministër, që ta bëjë Avokat të Popullit. Pas këtij debati, Thaçi ka kërkuar mirëkuptim për t'i kryer disa obligime, pastaj të kthehet në komision. Pas rikthimit të Thaçit në Komisionin Hetimor Parlamentar për deportimin e gjashtë shtetasve turq, debati është zhvilluar në frymën e njëjtë. Në disa çaste mbledhja është tensionuar jashtë mase, ku anëtari i këtij komisioni nga LDK-ja, Anton Quni, e ka pyetur Thaçin se pse është duke u frikësuar që të përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të këtij komisioni. Kjo përplasje ka filluar kur deputeti Quni i ka thënë Thaçit se është frikësuar në luftë. "E di që jeni frikësuar në luftë, por nuk e kuptoj pse frikësoheni tash në paqe", ka thënë Quni.

Pas kësaj deklarate ka reaguar Thaçi, i cili e ka quajtur Qunin mercenar të luftës. "Ti kur flet për luftë mos u djersit, se në luftë ke qenë kah fundi. Një këmbë e ke pasur në Shqipëri, një në Kosovë. Ke hyrë në Kosovë pasi ka hyrë NATO-ja. Ke luftuar, por ke qenë një mercenar luftëtar. Je një Boshko Buhë i paguar. Duhet t'ju vijë turp", i ka thënë Thaçi, Qunit.

Përplasja verbale për luftën ka vazhduar edhe ndërmjet Qunit dhe Hajdar Beqës. Quni e ka quajtur Beqën frikacak në luftë, ndërsa ky i fundit e ka quajtur Qunin luftëtar me korrespondencë. Pas këtyre akuzave të ndërsjella është mbyllur mbledhja e Komisionit Hetimor për deportimin e gjashtë shtetasve turq, ku nuk është bërë e qartë se si di do të vepron tutje.

KDI-ja kërkon që Kosova të prezantohet me zë unik në Samitin e Berlinit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 PRILL - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) nëpërmjet një letre publike dërguar presidentit Hashim Thaçi dhe kryeministrit Ramush Haradinaj ka kërkuar që në Samitin e Berlinit ta prezantojnë Republikën e Kosovës me një zë unik. Sipas KDI-së, një qasje e koordinuar institucionale që reflekton edhe vullnetin qytetar do të ndikonte në forcimin e pozitës negociuese të Kosovës në raport me Serbinë. "KDI-ja përmes kësaj letre të hapur publike ju bënë thirrje që si përfaqësues më të lartë të shtetit në këtë samit ta prezantoni shtetin e Kosovës me një zë unik sa i përket procesit të dialogut Kosovë - Serbi dhe çështjeve që ndërlidhen me këtë proces. Një qasje e koordinuar institucionale,



që reflekton edhe vullnetin qytetar, do të ndikonte në forcimin e pozitës negociuese të Kosovës në raport me Serbinë, si dhe do të përçonte mesazh të qartë te shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, se Kosova është duke trajtuar me përgjegjësi të gjitha obligimet ndërkombëtare", është thënë në letrën e KDI-së.

Instituti Demokratik i Kosovës vlerëson se pjesëmarrja e presidentit dhe kryeministrit në takimin e Berlinit pa një qëndrim të dakorduar institucional mund

ta dëmtojë pozicionin e Republikës së Kosovës në raport me pjesëmarrësit e këtij takimi, në veçanti dhe në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare, në përgjithësi. "Deklarimet e juaja publike gjatë muajve të fundit shpërfaqin dallime substanciale lidhur me fazën përfundimtare të dialogut dhe taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Duke ju përcjellë shqetësimin tonë lidhur me mungesën e një pozicioni të dakorduar institucional për

çështjet që do të diskutohen në këtë takim, ne vlerësojmë se Kosova rrezikon të paraqitet si shtet joserioz dhe pa vizion të qartë për rrugëtimin e mëtutjeshëm drejt integritetit evropian, ku normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë përbën një element kyç të këtij procesi", është theksuar më tutje në letrën e KDI-së drejtuar krerëve të shtetit.

Sipas këtij instituti, Samiti i Berlinit, në të cilin presidenti dhe kryeministri janë ftuar ta përfaqësojnë Republikën e Kosovës,

paraqet një nga iniciativat më të rëndësishme për promovimin e bashkëpunimit rajonal në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor, si dhe garantimin e stabilitetit në këtë rajon. "Duke qenë se marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë në fokus të angazhimit të BE-së, zhvillimet e fundit rreth fazës përfundimtare të dialogut Kosovë - Serbi pashmangshëm do të jenë pjesë e diskutimit në këtë Samit. Duke konsideruar se normalizimi i marrëdhënieve Kosovë - Serbi shihet si çështja e fundit e hapur në Ballkanin Perëndimor, pas zgjidhjes së çështjes së emrit në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, në kuadër të sferës së politikës së jashtme të BE-së, në këtë Samit, Kosova dhe Serbia do të inkurajohen që ta vazhdojnë dialogun për normalizimin e marrëdhënieve", është thënë në letrën e KDI-së.

Qeveria ndan një milion euro për dëmet e shkaktuara nga vërshimet në Rahovec

Me vendimin e miratuar nga kabineti qeveritar në mbledhjen e së premtes janë ndarë mjete financiare në shumë prej 1,000,000 euro për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet në Komunën e Rahovecit. Po ashtu, me propozimin e Ministrisë së Financave qeveria ka marrë vendim për lirim nga norma e taksës doganore për importet e shtazëve si: kuaj, gomarë, mushka, gjedhe, derra, shpend dhe kafshë të tjera të gjalla

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 PRILL - Qeveria e Kosovës ka emëruar të premtën komisionin përzgjedhës për rekomandimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik në përbërje: Rozafa Ukimeraj, sekretare e përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, kryesuese; Qemajl Marmullakaj, sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, anëtar; Naim Baftiu, sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Financave, anëtar; Osman Vishaj, përfaqësues i Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, anëtar; Isuf Zejna, Demokracia Plus, anëtar. Në këtë mbledhje të qeverisë është aprovuar pjesërisht kërkesa e Shoqatave të Dala nga Lufta e UÇK-ë, për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 390.000 eurosg. Mjetet e ndara do të përdoren për funksionim të shoqatave, për rehabilitim dhe trajtim të pjesëtarëve të shoqatave

dhe për mbulimin e shpenzimit të varrimit të veteranëve të luftës së UÇK-së.

Me vendimin e miratuar nga kabineti qeveritar në mbledhjen e së premtes janë ndarë mjete financiare në shumën prej 1,000,000 eurosh për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet në Komunën e Rahovecit.

Me propozimin e Ministrisë së Financave qeveria ka marrë vendim për lirim nga norma e taksës doganore për importet e shtazëve si: kuaj, gomarë, mushka, gjedhe, derra, shpend dhe kafshë tjera të gjalla. Gjithashtu, janë liruar nga tatimi doganor për mallrat e importuara nga Bashkësitë Fetare, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së tyre financiare.

Në këtë mbledhje ka marrë miratimin e kabinetit qeveritar nisma për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare me Republikën e Francës për vendosjen dhe aktivitetet e Agjencisë Franceze për Zhvillim, PROPACO dhe Expertise France në Kosovë.

Qeveria ka miratuar edhe raportin e parë tremujor të buxhetit për vitin 2019. Raporti është përgatitur në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, të cilat i përcillen Kuvendit brenda 30 ditësh nga mbarimi i çdo tremujori. Pranimet në buxhet në këtë periudhë janë 464,79 milionë euro, ndërsa shpenzimet në total janë 401,02 milionë euro.

Kabineti qeveritar ka aprovuar edhe programin e borxhit shtetëror për vitet 2020 -2022, të cilin do ta procedojë në Kuvendin e Kosovës.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020 - 2022 (KASH 2020-2022), e aprovuar në mbled-

hjen e sotme të kabinetit qeveritar, paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin 2020.

Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për ta vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të qeverisë. Duke marrë parasysh strukturën aktuale ekonomike të Kosovës dhe pengesat e shumta në rritje ekonomike, është e nevojshme ndërmarrja e reformave ekonomike për ta liruar dhe fuqizuar potencialin ekonomik të vendit.

Prioritetet e reformave ekonomike për periudhën afatmesme burojnë nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Programi për Reforma në Ekonomi 2019 - 2021, i cili rrjedh nga procesi i dialogut për qeverisje ekonomike ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Kryeministri Haradinaj në këtë mbledhje ka folur edhe për ndalesat e zyrtarëve serbë të cilët punojnë në institucionet e Kosovës, nga institucionet e Serbisë, ku vlerësoi se kjo situatë është e papranueshme, duke paralajmëruar edhe kundërmasa në raport me zyrtarët serbë të cilët vizitojnë Kosovën.

ShBA-ja përgëzon PZAP-në dhe KQZ-në për certifikimin partive për zgjedhjet në komunat në veri

PRISHTINË, 26 PRILL - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë ka përgëzuar Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për certifikimin e të gjithë kandidatëve të kualifikuar për zgjedhjet për kryetarë komunash në katër komunat veriore të Kosovës të cilat do të mbahen më 19 maj. "Ambasada e ShBA-së përgëzon Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për vendimin për të certifikuar të gjithë kandidatët e kualifikuar për zgjedhjet e 19 majit për kryetarë komunash në katër komunat veriore dhe lëvdon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për veprimin e shpejtë në konfirmimin e vendimit të PZAP-së dhe procedimin me aktivitetet që lidhen me zgjedhjet e jashtëza-



konshe në veri", thuhet në kumtesën për media të Ambasadës së ShBA-së. Më tutje në deklaratën e

Ambasadës Amerikane thuhet që kryetarët që do të dalin nga këto zgjedhje duhet t'i përbushin mandatet e tyre duke

punuar brenda institucioneve të Kosovës. "Një KQZ jopartiake dhe e kompletuar me anëtarë, është qenësore për rregullimin

dhe monitorimin efektiv të zgjedhjeve të cilat janë element themeltar i demokracisë së Kosovës. Pas zgjedhjeve për kryetarë komunash, kandidatët fitues duhet t'i përbushin mandatet e tyre duke punuar brenda institucioneve të Kosovës në emër të zgjedhësve të tyre".

Katër kandidatët e subjektit politik, Lista Serbe, nuk kishin arritur të certifikohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shkak se dy anëtarët e këtij trupi nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje kishin abstenuar në votim, duke pamundësuar certifikimin. Por, të enjten Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa përmes një vendimi e urdhëroi KQZ-në që ta certifikojë këtë subjekt politik dhe kandidatët e saj për zgjedhjet e jashtëzakonshme komunale për katër komunat veriore.

Reagim i KMDLNj-së

A janë trajtuar në përputhje me të drejtat e njeriut të kthyerit nga Siria?!



Kohë më parë janë kthyer nga Siria katër (4) meshkuj që kanë luftuar në këtë vend, 32 femra si dhe 74 fëmijë. Pas kthimit të tyre, shumica e udhëheqësve institucionale garonin se kush ka më shumë merita për kthimin e tyre ndonëse, pa përkrahjen ndërkombëtare ky kthim do të ishte i porealizueshëm. KMDLNj vlerëson se kthimi i shtetasve kosovarë nga Siria është në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sikur që është edhe detyrim shtetërorë. Kushtet ku janë vendosur pas kthimit dhe trajtimi i tyre nga institucionet përgjegjëse kanë qenë të mira dhe të pakrahshueshme me kushtet ku kanë jetuar nëpër kampet për refugjatë në Siri. Sipas KMDLNj-së, problemi me të kthyerit ka filluar pasi është bërë publik struktura e të kthyerve e që është përcjell me një qasje stigmatizuese që, në disa raste ka kaluar në racizëm të papranueshëm dhe të dënueshëm. Autoritetet

kosovare, pas verifikimit kanë filluar procedurën penale ndaj katër meshkujve që kanë luftuar në Siri sikur që, edhe shumica e femrave janë intervistuar e që pastaj një numri u është caktuar masa e arrestit shtëpiak. Fëmijët u janë kthyer familjeve kurse për ata fëmijë që nuk kanë pasur prindër janë dhe po kujdesen qendrat për punë sociale. Deri këtu është kryesisht në rregull. Stigmatizimi i tyre fillon me femrat për të cilat thuhet se janë martuar disa herë thuaja se kjo paraqet ndonjë interes për publikun. Stigmatizimi pastaj vazhdon me pamjet filmike ku shihen duke u dërguar në gjykatë të mbuluara me burka në vend se t'i dërgojnë në mënyra tjera e që në këtë fazë të mos i ekspozohen publikut. KMDLNj e vlerëson krejtësisht të papranueshme qasjen ndaj fëmijëve të kthyer duke i vënë në fokus të trajtimit racist, si nga komentues të papërgjegjshëm, ashtu edhe nga figura publike dhe institucionale. Të deklarosh botërisht se ata fëmijë nuk është dashur të kthehen sepse janë fëmijë të ISIS-it, se nuk dihet kush janë prindër të tyre apo, merreni me mend!!! se është dashur t'u bëhet ADN e pastaj të kthehen është racizëm i ndyrë

dhe kundër çdo standardi të drejtave të njeriut. T'i ngarkosh këta fëmijë me përgjegjësi për papërgjegjësinë e të tjerëve, në rastin konkret të prindërve të tyre apo rrethanave për të cilat, as nuk kanë kontribuar e as që kanë mundur të ndikojnë, është kundër çdo morali njerëzorë. KMDLNj e vlerëson dhe përkrahë kthimin e qytetarëve të Kosovës deri më tani sikur që pret të kthehen edhe shtetasit kosovarë që ende janë në Siri. KMDLNj propozon që përdorimi i burkas në vende publike të ndalohet me ligj dhe të mos lejohet që në gjykatë të hyjnë me burka. Ndalimi i përdorimit të burkas në vende publike nuk bie në kundërshtim me të drejtat e njeriut prandaj edhe duhet të sanksionohet me ligj. Burka po krijon paragjyqime të opinionit ndaj atyre që e bartin sikur që bartësit e burkas po i identifikon me një dhunë potenciale. KMDLNj nuk ka asnjë dilemë për ndalimin e burkas në vende publike. KMDLNj kërkon që të ndërpriten komentet raciste sipas argumentit të gjakut kundër fëmijëve të kthyer dhe të ndihmohet në integrimin e tyre duke mos i ndërlidhur me asnjë përgjegjësi për të kaluarën e tyre.

KMDLNj, gjithashtu kërkon që masa e arrestit të shqiptohet vetëm si masë e skajshme, kur të shteren të gjitha mundësitë tjera sikur që institucionet e Kosovës duhet ta shqyrtojnë dhe ta ndryshojnë strategjinë e punës me këtë kategori të të privuarve nga liria sepse, deri më tani masat e ndërmarrja kanë dështuar krejtësisht. Kjo kategori duhet të trajtohet në përputhje me ligjin sikur të gjithë të dënuarit tjerë duke i gëzuar të gjitha privilegjet që u takojnë sikur edhe të gjitha përgjegjësitë. Ligjërimi i imamëve të BIK-ut në burgjet kosovare është eksperiment i dështuar e që për pasojë ka se prodhon efekte të kundërta e asaj që synohet. KMDLNj i ka vizituar të gjithë të privuarit nga liria të cilësuar si radikalë islamikë, disa herë dhe konstaton se ky është grupi më i disiplinuar në burgjet e Kosovës që e respektojnë rendin shtëpiak, mbajnë rregull dhe qetësi kurse mbajtja e pastërtisë është shembullore. Këta të burgosur i kanë deklaruar KMDLNj-së ndihen të burgosur si "kurbanë" të liberalizimit të vizave e jo për shkak të bindjeve që i kanë. KMDLNj vlerëson se kjo kategori e të privuarve nga liria në Kosovë është e diskriminuar dhe nuk i

gëzojnë të drejtat e plota e sidomos janë të përjashtuar nga beneficionet, lirim me kusht dhe të drejtat e tjera që, nëse do të realizoheshin, pa i diskriminuar, do të ndihmonte shumë në risocializimin e tyre dhe integrimin në shoqëri. Nëse trajtohen në këtë mënyrë si deri më tani, refuzimi për të pranuar programin e risocializimit do të jetë në shkallën 100 për qind dhe përgjegjës për këtë jemi të gjithë; institucionet sepse masat represive i vënë para atyre edukative, Shërbimi Korrektues i Kosovës sepse duke iu nënshtruar vlerësimeve dhe diktateve politike kanë qasje paragjyquese kurse organizatat monitoruese për faktin se për një përfitim material mbajnë qëndrim oportunist duke mos i identifikuar problemet e vërteta dhe duke u bërë pjesë e stigmatizimit. KMDLNj vlerëson se në mesin e të arrestuarve e që cilësohen si radikalë islamikë, xhihadistë apo ISIS me një ofertë të sinqertë nga shteti dhe me një qasje racionale të institucioneve përgjegjëse ka të tillë që mund të kthehen dhe të integrohen në shoqëri si qytetarë të barabartë, me të gjitha detyrimet dhe përgjegjësit e që këtë mundësi nuk e kanë pasur deri më sot.

Veseli: Epopeja e Melenicës është dëshmi e sakrificave të Shalës për liri

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Duke përkujtuar sakrificën e të rënëve për liri, nën përkujdesjen e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, të premten është mbajtur akademi përkujtimore në nderim të dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të rënë 20 vjet më parë në betejën e Melenicës, në Mitrovicë.

Në këtë akademi përkujtimore ka marrë pjesë edhe presidenti Hashim Thaçi.

Në fjalën e tij para të pranishmëve në Teatrin Kombëtar në Prishtinë, kryeparlamentari Veseli ka thënë se rajoni i Shalës, Mitrovicës, ka dhënë shumë që nga fillimi vitet e shekullit 20 për lirinë dhe pavarësinë e shqiptarëve. Ai ka theksuar se ishte pikërisht heroi i kombit Isa Boletini i cili më 1912 shkoi nga Mitrovica në Vlorë për formimin e shtetit shqiptar, ndërsa theksoi se u dëshën edhe 86 vjet të tjera sakrificat e dëshmorë deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Kreu i Kuvendit ka thënë se Epopeja e Melenicës është dëshmi e sakrificave të Shalës për liri.



"Gjatë gjithë historisë Shala e Bajgorës ka rrezatuar atdhedashuri. Burrat e saj gjithmonë kanë qenë aty ku është dhënë kushtrimi për liri e për komb. E tillë ishte kjo zonë edhe në luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishin djemtë e vajzat më të mirë të Kosovës që iu përgjigjen thirrjes për çlirimin e atdheut", ka thënë Veseli.

Ai ka thënë se për një muaj rresht djemtë e saj u qëndruan heroikisht sulmeve të makinerisë ushtarake serbe, në të cilat betejat ranë heroikisht Shemi Ahmeti, Rustem Hyseni, Ahmet e Xhemal Haxha, Asllan Cimili, Enver Musa, Shemi Isrefi, Faruk Beqiri, Sokol Preteni, Esat Mehollu, Qazim Cimili. "Ata ranë, por ëndrra e tyre për liri u bë

realitet. Liria e Kosovës është pavdekësia e tyre, sepse sa të jetë e lirë kjo tokë, do të jetojë edhe emri i tyre. Dhe kjo tokë përgjithmonë ka me qenë e lirë. Ka me qenë e pavarur dhe sovranë, përderisa të nxehë dielli e të rrezojë hana, siç do të thoshte Fishta. Nuk do të mund të na ndalë askush. Nuk ka sfida që mund të na gjunjëzojë", ka

thënë kryeparlamentari Veseli. Bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, presidenti Hashim Thaçi i ka dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës" dëshmorët Amet Haxha, Asllan Cimili, Enver Musa, Esat Mehollu, Qazim Cimili, Rustem Hyseni, Sokol Preteni, Shemi Istrefi dhe Xhemal Haxha.

BQK-ja revokon licencën e kompanisë së sigurimeve 'Insig'

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 PRILL- Bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), që rrjedhin nga nenin 36 dhe 67 i Ligjit për BQK-në, si dhe në pajtim me nenin 16, nenin 99, nenin 100 dhe nenin 124 të Ligjit për Sigurimet, në takimin e mbajtur të premten, Bordi Ekzekutiv i BQK-së ka marrë vendim që kompanisë së sigurimit "Insig" SH.A., dega në Kosovë, t'i revokohet licenca nr. 003 e datës 25 mars 2002, e lëshuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK), paraardhëse ligjore e BQK-së.

Kompania e Sigurimit "Insig" SH.A., Dega Kosovë, ka pasur vështirësi financiare për përmbushjen e kërkesave ligjore të BQK-së për sa i përket mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese - solvencës. "Në funksion të përmirësimit të gjendjes financiare dhe përmbushjes së kërkesave ligjore dhe rregullative, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, përkatësisht Bordi Ekzekutiv i BQK-së, në pajtim me legjislacionin në fuqi, në mënyrë të vazhdueshme ka bërë përpjekje për ta sanuar gjendjen financiare të kompanisë së sigurimit 'Insig' SH.A., Dega Kosovë. Megjithatë, përkundër gatishmërisë dhe përpjekjeve të BQK-së, Bordi dhe Menaxhmenti i Siguruesit nuk ka arritur t'i përmbushë kërkesat ligjore dhe përmirësimin e gjendjes financiare të Kompanisë", thuhet në njoftimin e BQK-së.

Sipas këtij njoftimi, në të njëjtën kohë aksionari i kompanisë së sigurimit "Insig", Dega në Kosovë, nuk iu ka përgjigjur kërkesave të BQK-së për rritjen e kapitalit dhe

arritjes në pajtueshmëri me kërkesat ligjore në fuqi. "Mungesa e gatishmërisë së aksionarit për t'i plotësuar kërkesat e kapitalit ka vënë në rrezik serioz kapacitetet e kompanisë për t'i përmbushur detyrimet ndaj të siguarve dhe kreditorëve të tjerë. Prandaj, me qëllim të mbrojtjes së policëmbajtësve dhe me qëllim të parandalimit të rritjes së ndikimit negativ në tregun e sigurimeve dhe në sistemin financiar në përgjithësi, BQK-ja, duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për BQK-në dhe Ligji për Sigurimet, ka marrë vendim për revokimin e licencës së kompanisë", thuhet në njoftimin e BQK-së.

BQK-ja ka hapur procedurat e likuidimit të detyrueshëm, sipas kapitullit 18 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet, duke emëruar likuidatorin, i cili do ta drejtojë kompaninë e sigurimit në likuidim "Insig" dhe do të sigurojë trajtim të drejtë dhe të barabartë, gjithmonë në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi, ndaj të gjithë kreditorëve. "Me emërimin e likuidatorit pushojnë të gjitha përgjegjësitë e Administratorit, të Bordi Drejtues dhe Menaxhmentit të Kompanisë në raport me menaxhimin e kompanisë. Likuidatori do të jetë në dispozicion të shqyrtimit të të gjitha kërkesave, në radhë të parë të policëmbajtësve, si dhe kreditorëve të tjerë. Likuidatori do të raportojë për çdo muaj në BQK lidhur me mbarëvajtjen e përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve. Në të njëjtën kohë likuidatori do t'i njoftojë më hollësisht të gjithë kreditorët dhe palët e tjera me interes lidhur me mënyrën e komunikimit dhe do të sigurojë kontakte të telefonit, e-mailit dhe lokacionin për paraqitjen e të gjitha kërkesave të policëmb-



bajtësve dhe kreditorëve të tjerë", është theksuar në njoftimin e BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës udhëzon të gjithë policëmbajtësit dhe kreditorët e tjerë që t'i përcjellin njoftimet në ditët në vijim nga likuidatori dhe BQK-ja lidhur me udhëzimet mbi procesimin e kërkesave që kanë në raport me kompaninë e sigurimit në likuidim "Insig". "BQK-ja, në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara nga Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe ligjet e tjera përkatëse që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve financiare, do t'i vazhdojë aktivitetet e saj për të siguruar përputhje të plotë të veprimtarisë së institucioneve financiare me kërkesat e përcaktuara nga ligjet dhe rregulloret në fuqi. Ruajtja e aftësisë së institucioneve financiare për t'i përmbushur detyrimet financiare ka një rëndësi shumë të madhe për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, që paraqet

edhe objektivin primar të BQK-së.

Prandaj, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe mbrojtjes së shfrytëzuesve të shërbimeve financiare, BQK-ja mbetet e përkushtuar që t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë ligjore për ta siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit të sistemit financiar në vend, duke i siguruar ekonomisë së vendit një sistem financiar në funksion të zhvillimit dhe stabilitetit makroekonomik, si dhe një sistem që ofron siguri për të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve financiare", është thënë në njoftimin e BQK-së. Sipas BQK-së, revokimi i licencës së kompanisë së sigurimit "Insig" nuk rrezikon qëndrueshmërinë e sektorit të sigurimeve në Kosovë. "Sistemi financiar i Kosovës, që nga fillimi i funksionimit të tij, ka pasur një zhvillim të qëndrueshëm dhe ka shërbyer si burim i rëndësishëm i stabilitetit makroekonomik në vend. Në vitet e fundit kemi

një përshpejtim të rritjes së aktivitetit pothuajse në të gjithë komponentët e sistemit financiar, përderisa edhe treguesit e performancës dhe qëndrueshmërisë kanë shënuar përmirësim të mëtejshëm. Për sa i përket sektorit të sigurimeve në veçanti, aktiviteti i këtij sektori po vazhdon të rritet, përderisa masat rregullative dhe mbikëqyrëse të ndërmarra nga ana e BQK-së kanë rezultuar në një performancë financiare pozitive të këtij sektori, pas një periudhe mjaft të gjatë me humbje. Prandaj, ne zotohemi që do ta vazhdojmë ndërmarrjen e të gjitha masave që i parasheh ligji në mënyrë që në tregun tonë ta lejojmë operimin e vetëm atyre institucioneve financiare që janë të afta t'i kontribuojnë zhvillimit të mëtejshëm të sistemit financiar dhe ekonomisë së vendit, si dhe t'i kontribuojnë fuqizimit të mëtejshëm të stabilitetit financiar", është theksuar në njoftimin e BQK-së.

Përrurohet shiriti rrugor shtesë në pikën doganore të Morinës

PRISHTINË, 26 MAJ (ER) - Ministri i Infrastrukturas dhe Transportit, Pal Lekaj, bashkë me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, të premten mori pjesë në përrurimin e shiritit rrugor shtesë në pikën doganore të Morinës, kufiri Kosovë - Shqipëri. Ky shirit shtesë do ta ndihmojë qarkullimin edhe më të lirë e të shpejtë të njerëzve dhe mallrave nga të dyja anët e kufirit.

Duke folur për rëndësinë e këtij projekti infrastrukturor, ministri Pal Lekaj deklaroi se ky shirit shtesë është në

shërbim të lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe mallrave, sidomos për transportuesit nga të dyja anët e kufirit. Lekaj tha se bashkëpunime të tilla si ky ndikojnë dukshëm në relacionet vëllazërore në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Ambasadori Mixhozi e falënderoi ministrin Lekaj dhe dikasterin që ai përfaqëson për kontributin për realizimin e këtij projekti që ishte prolonguar për një kohë të gjatë por që, falë angazhimit të ministrit Lekaj, u krye në më pak se 10 ditë.



KFOR-i italian dhuron pajisje mjekësore për QKMF-në në Malishevë

MALISHEVË, 26 PRILL - (ER) Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Malishevë ka qëndruar komandanti i grupit shumëkombësh luftarak-perëndim të KFOR-it, kolonel Gianfranco Di Marco, i shoqëruar edhe nga shoqata nazionale alpine, seksioni Trento, të cilët i kanë dhuruar një donacion në pajisje mjekësore për QKMF-në. KFOR-i italian dhe përfaqësuesit

e kësaj shoqate italiane janë pritur nga drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Liridon Hoti dhe drejtori i QKMF-së në Malishevë, Nuhi Morina, të cilët i kanë falënderuar KFOR-in dhe shoqatën italiane për këtë donacion domethënës. Donacioni i sjellë përmes KFOR-it italian, nga shoqata nazionale alpine, seksioni Trento nga Italia, është dy defibrilator

dhe një elektrokardiogram (EKG), të cilët kanë qenë shumë të nevojshëm për QKMF-në në Malishevë.

Në emër të Komunës së Malishevës, drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Liridon Hoti, e ka falënderuar KFOR-in dhe shoqatën italiane për këtë donacion që, sipas drejtorit Hoti, kanë rëndësi të madhe për QKMF-në dhe popullatën e Malishevës.



'Hardh Fest' për herë të parë vjen në muajin gusht



RAHOVEC, 26 PRILL (ER) - Festa e vjeljes së rrushit - Festivali "Hardh Fest", edicionin e kaluar shënoi një sukses të madh, ku numri i pjesëmarrësve arriti mbi 61 mijë vizitorë nga mbarë bota.

Festivali që sjell më së shumti turistë në Kosovë, "Hardh Fest", këtë vit po vjen me një ndryshim të madh. Për herë të parë, ky festival tradicional do të mbahet në muajin gusht, konkretisht më datat 16, 17 dhe 18 gusht, në Konak të Rahovecit dhe është jubileu i pesëvjetorit të ribrendimit të festivalit më të vizituar në Kosovë.

"Hardh Fest" sjell një nga përvojat më të bukura jetësore

për të gjithë ata që e vizitojnë festivalin, duke nisur nga mikpritja rahoveciane deri te "Hardh Campi" që ka një pamje të bukur të vreshtave të Rahovecit, e më pas ka aktivitete të cilat kanë për qëllim promovimin e prodhimeve të rrushit, por edhe mjedisit, kulturës dhe artit, një ngërthim ky që tashmë është shndërruar në storie suksesi. Festivali organizohet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, si dhe në përkrahje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe sponsorëve të festivalit.

Komuna e Prishtinës kërkon të largohen mbeturinat në qytet

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Komuna e Prishtinës përmes një njoftimi për media ka theksuar se nuk duhet lejuar që për shkak të problemeve dhe çështjeve të pazgjedhura brenda kompanive publike që ofrojnë shërbime të pësojnë qytetarët e Prishtinës. "Për më tepër, Kompania

'Pastrimi' është kompani rajonale dhe pasojat barten edhe në komunat e tjera. Situata me mbeturinat e krijuara është e papranueshme! Por, edhe paraqet rrezik serioz për shëndetin publik të të gjithë neve. Ftojme të gjithë faktorët relevantë që urgjentisht ta bëjnë zhblokimin e

kësaj situatë të patolerueshme. Komuna e Prishtinës është treguar e gatshme t'i huazojë 4 000 litra derivate për kompaninë 'Pastrimi', në mënyrë që të evitohet kjo gjendje alarmante", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



Sanohen dëmtimet e rrugëve në Prizren

PRIZREN, 26 PRILL (ER) - Me përmirësimin e kushteve atmosferike, Drejtoria e Shërbimeve Publike në Prizren këto ditë ka shtuar edhe ritmin e punës për rehabilitimin e rrugëve kryesore në qytet. Në unazën e

qytetit po zhvillohen punimet me asfaltim për evitimin e gropave, kurse në trotuare dhe rrugë dytësore po intervenohet me shtrimin e kubëzave me qëllim të përmirësimit të gjendjes rrugore.

Muharremaj nënshkruan marrëveshje për renovimin dhe mirëmbajtjen e lapidarëve në Suharekë

SUHAREKË, 26 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, dhe drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e


Komplekseve Memoriale, Bislim Zogaj, kanë nënshkruar të premten marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje nënkupton realizimin

e projektit "Renovimi dhe mirëmbajtja e lapidarëve" në vlerë prej 125,000,00 eurosh. Me këtë rast, kryetari Muharremaj ka thënë se

lapidarët dhe varetat e dëshmorëve në Komunën e Suharekës do të rregullohen dhe do ta kenë trajtimin e merituar institucional.



Sfida e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut



Bedri ISLAMI

Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut ndodhen para një sfide të re, ndoshta nga më të rëndësishmet në vitet e fundit: ata do të vendosin se kush do të jetë presidenti i ri i këtij vendi por, jo vetëm kaq, përmes verdiktit të tyre do të përcaktohet në një shkallë të madhe edhe e ardhmja e këtij shteti përmes dy rrugëve: njëres propeëndimore, evropiane dhe progresive dhe, tjetres, rikthimit nën petkun e një nacionalizmi të sëmurë, kthimit në pushtetin presidencial të përfaqësimit të një klase politike të zvetënuar, thellë të korrupsuar, që në vitet e pushtetit të tyre të zgjatur, bën pak ose aspak për shqiptarët.

Koha e vendosjes është tani dhe jam i bindur se shqiptarët do ta bëjnë zgjedhjen e duhur, të vetmen të drejtë dhe në prirjen e tyre drejt shtetit shumetnik, ku vetë ata do të jenë element shtetformues jo vetëm në letër, por në të gjithë spektrin e tyre. Pse është sfida e tyre më e rëndësishme e kësaj kohe dhe çfarë pritet?

Raundi i parë i zgjedhjeve politike në Maqedoninë e Veriut për presidentin e ri dëshmoi shumë gjëra, mbi të gjitha, se duan apo nuk duan maqedonasit, gjithçka rreth tyre, që nga qeverisja dhe deri te presidenti, varen pikërisht nga forca e shqiptarëve dhe përcaktimi i

tyre. Atë që do t'i përkrahin shqiptarët, ai do të jetë në qeveri, ai do të jetë forcë e parë parlamentare, ai do të ketë të drejtën e zyrës presidenciale. Llogaritë tani janë të thjeshta, të hapura dhe të lexueshme. Nëse më parë, e gjithë mund të ishte një lojë skenike, ku luhej me votën shqiptare, tani miti i rremë ka rënë, e vërteta është sheshit dhe e dukshme. E gjithë kjo e ka një fillësë dhe, sado që mund të ketë përpjekje për harrim, çdo gjë lidhet me Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare dhe më pas me forcën politike përfaqësuese të saj, BDI dhe liderin e saj, Ali Ahmeti.

Në garën presidenciale ishte edhe një emër i njohur: Blerim Reka, i cili solli një risi në paraqitjen publike të shqiptarëve. Blerim Reka është një politikan i spikatur, të cilin të gjithë udhëheqësit shqiptarë edhe në Kosovë kanë dashur që të jetë në stafin e tyre jo si një nga këshilltarët e zakonshëm, por si rregullatori i mendimit politik. Është njeri i lexuar, i qetë, me prirje drejt kombëtares, i saktë në mendimin e tij dhe i besuar. Kjo solli që të ketë besueshmëri shumë të lartë, shumë më të lartë sesa forcat politike që e mbështetën, njëra nga të cilat është me prirje erdoganiste dhe religjioze, ndërsa tjetra, në këtë moment, lidhet pas një emri.

Pjesëmarrja e ulët e shqiptarëve në votimet e para lidhet pikërisht me dualitetin e krijuar rreth emrit të Blerim Rekës, nga njëra anë, dhe një propagande frenetike që iu bë forcave të tjera, të cilat nxituan të cilësojnë si tradhtar të kauzës gjithsecilin që do të votonte për një figurë

politike joshqiptare.

Mes dyzimit për politikanin shqiptar dhe forcës politike që i besojnë, BDI-së, ata zgjedhën bojkotin dhe heshtjen.

Por, edhe sikur të gjithë votat shqiptare të ishin tek i njëjti njeri, ai do të dëshmonte kaq sa është dëshmuar: kush vendos, por nuk do të mund të ishte përcaktues. Mes realizimit politik dhe entuziazmit politik, mvëshur me një nacionalizëm diletant, ka gjithnjë një ndarje dhe një pamundësi.

Në politikë duhet ditur se në cilin moment duhet përdorur "lopata" dhe se kur duhet vënë në përdorim "shati", pra kur duhet të japësh dhe kur duhet të marrësh.

Shqiptarët janë pjesë e qeverisë së shtetit maqedonas, jo në institucione të dorës së dytë, por në disa raste, në vendosëse. Sidoqoftë, edhe më herët, pas vitit 2001, duke pasur këtë të drejtë, ata nuk kanë ecur më tej, pasi e gjithë rryma nacionaliste e Gruevskit, manipulimet dhe pushteti, ku shpeshherë ai do të mund të ndërtonte një qeveri fillikat, kanë ngushtuar mbijetesën politike shqiptare, por nuk e kanë hedhur tej.

Ndërtimi i një bashkëpunimi të ri politik në mes të Zajevit dhe Ahmetit jo vetëm në pushtet, por edhe në institucione, solli që, për herë të parë, në Maqedoninë e Veriut, njëri ndër tre institucionet më të rëndësishme, Kuvendi i tij, të drejtohet nga një politikan shqiptar, figurë e njohur atdhetare dhe përfaqësues i aspiratave të lëvizjes çlirimtare. Kjo nuk kishte ndodhur më parë dhe duhet pranuar se ndërtimi i një skeme politike duhet bërë

gjithnjë mbi bazën e mundësisë dhe jo të dëshirës.

Nëse zgjedhja e kryetarit të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut do të jetë dhe është një politikan shqiptar dhe kjo ishte shati që mblodhi rreth vetes një post drejtues të dorës së parë, për shqiptarët është koha që, mes dy rrugëve, të zgjedhin njërin prej tyre, sado e dhimbshme të jetë dhe sado që dikujt mund t'i duket antikombëtare.

Shqiptarët nuk kanë rrugë tjetër, duhet të përcaktohen për njërin prej tyre: ose të kthehen te rruga e vjetër e konflikteve dhe përplasjeve nacionaliste, jo vetëm mes tyre dhe një pjesë të çartur të nacionalistëve maqedonas, pasues të politikës së Gruevskit, por edhe të mendimit liberal perëndimor me mendimin sllav të politikës ruse, ose të ndjekin një aspiratë perëndimore evropiane.

Dyzimi nuk ka të bëjë me nacionalizimin apo antinacionalizmin. Nëse duhet pranuar se në fazën e një stadi politik, shqiptarët përdorën "shatin" politik, tani ka ardhur koha, dita, çasti që ta përdorin "lopaten" e politikës së tyre: të përcaktohen, duke falur nga vetja.

Të dy partitë politike maqedonase në këto ditë përbetohen për shqiptarët, për lojalitetin ndaj tyre, do të premtojnë gjithnjë e më shumë, megjithëse gjuhën shpeshherë do ta mbajnë brenda dhëmbëve nga dhimbja se kanë mbetur në duart e shqiptarëve. Është traditë e tyre premtimi para betejës politike dhe injorimi pas saj, por këtë herë rregullat e lojës kanë ndryshuar. Shumë gjëra kanë ndryshuar.

Qeveria e tashme, megjithëse nuk është ashtu si do të kishin dashur, është më liberale dhe më shpresdhënëse, më e afërt me shqiptarët dhe më e hapur.

Nga ana tjetër, nacionalistët e Gruevskit, si hije e mendim politik i tij, kanë pasur shumë vite kohë për t'i ndrequr marrëdhëniet me shqiptarët por, në të kundërtën, ngritën nga vetja dhe krijuan aksionin e përgjakshëm të Kumanovës, sajuan gjyqe të egra kundër shqiptarëve, ngritën kultet nacionaliste të etnisë së tyre dhe, edhe tani, janë shprehur haptas kundër disa ligjeve themeltare, si zyrtarizimi i gjuhës shqipe, i cili nuk u nënshkrua nga presidenti i deritashëm, pikërisht përfaqësues i partisë së tyre dhe nuk ka asnjë premtim konkret nëse do të nënshkruhet një ditë nëse vazhdon e njëjta parti në zyrën presidenciale. Ata u përpoqën të bëjnë një grushtshteti institucional, duke synuar ta zaptojnë parlamentin, duke dënuar kryetarin e saj shqiptar, duke gjakosur deputetë, përmes huliganësh që edhe sot janë pasvijë e politikës së tyre.

Nga do të shkojë Maqedonia, këtë do ta vendosin shqiptarët. Jam i bindur se edhe më tej, pavarësisht prej dyzimit fillestar, ata do të jenë në kahun e progresit dhe jo të kthimit pas; do të jenë për mendimin evropian dhe jo vazhdim i mendësisë sllave.

Koha ka ardhur. Nëse mësimi i parë është dhënë, pikërisht ai që në këtë shtet vendosin tashmë shqiptarët, është koha e mësimi të dytë, që shqiptarët kanë vendosur të jenë pjesë e Evropës dhe jo pjesë e ndryshkut neocarist rus.

Kosova ka shënuar hapa konkretë në fushën e të drejtës së autorit

PRISHTINË, 26 PRILL (ER)- Në Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, në Kosovë u organizua konferenca "Të drejtat pronësore intelektuale". Në këtë konferencë të bashkorganizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë morën pjesë zëvendësministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Leonora Morina, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala dhe drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha.

Konferenca për pronësinë intelektuale është e fokusuar në sistemin e pronësisë intelektuale në Kosovë, konkretisht në të arriturat e institucioneve gjatë vitit kalendarik dhe sfidat. Zëvendësministria Morina në

fjalën e saj të rastit ka thënë se Kosova ka vazhduar të marrë hapa në fushën e të drejtës së autorit. "Në fund të vitit që lamë pas kemi miratuar rregulloren e re për kompensimet e veçanta për të siguruar kështu kompensime shtesë për autorët e krijuesit tanë. Së fundi kemi hartuar strategjinë për forcimin e sistemit të të drejtave të autorit 2019-2023. Kjo strategji do të ndikojë fuqishëm në vetëdijesimin dhe edukimin e shoqërisë për rëndësinë e të drejtës së autorit dhe zbatimin e këtyre të drejtave në vendin tonë", ka thënë ajo.

Ndërkaq ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se karshi sistemit të pronësisë intelektuale forcimi i pronësisë intelektuale është prioritet i ministrisë që drejton.



E rrallë

Lind fëmija 'i dehur'

Një 35-vjeçare nga Lituania është paditur pasi ka lindur një fëmijë me shumë alkool në sistemin e tij, që shkakton probleme serioze në shëndet. Mamaja kishte qenë e dehur gjatë lindjes. Doktorët thanë se fëmija, vajzë, kishte alkool në sistemin e saj, aq sa ka një i rritur në gjendje shumë të dehur dhe mund të shkaktojë probleme të mundshme në funksion të zemrës dhe të frymëmarrjes.



FOTO E DITES



Mbetjet e plastikës shihen duke lundruar në një kanal kanalizimesh në kryeqytetin e Haitit Port-au-Prince. /AFP/

E jashtëzakonshme

Gjendet anija australiane e Luftës së Dytë Botërore në oqean

Një anije australiane e mbytur nga një nëndetëse japoneze në Luftën e Dytë Botërore është gjetur pas 77 vjetësh. SS Iron Crown, një anije mallrash detare, u qëllua jashtë shtetit të



Victorias në vitin 1942. Nga sulmi mbetën të vdekur 38 njerëz. Vetëm pesë anëtarë të ekuipazhit mbijetuan. Anija u mbyt brenda 60 sekondave pas sulmit në Bass Strait.

BARSOLETA E DITËS



- Kur ndodh një parainfarkt?
- Kur në xhep s'e gjen celularin.
- Po infarkti?
- Kur ta merr telefonin gruaja dhe nuk e ke me kod.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

"THE KID WHO WOULD BE KING",

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

"CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

"U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Keni lajme të bukura që doni t'i ndani me të gjithë. Do të gjeni disponibilitetin e personave që ju duan dhe ju mbështesin.



DEMI

Këtë ditë doni të merrni përgjegjësi të reja mbi vete. Planet tuaja do i konsultoni me partnerin.



BINJAKËT

Sot do t'ju shoqërojnë gjatë ditës tuaj persona të gëzueshëm dhe mjaft të vendosur.



GAFORRJA

Instikti juaj ju çon drejt një drejtimi që nuk ishte destinacioni juaj parësor. Gjithsesi është më i miri.



LUANI

Sot mjafton të ndani mirë oraret e ditës dhe çdo gjë do t'ju shkojë siç dëshironi. Partneri ka një kërkesë për ju.



VIRGJERESHA

Objektivat e ditës suaj përqendrohen vetëm tek puna. Mos harroni që dhe familja ka të njëjtën rëndësi.



PESHORJA

Ditën e sotme duhet të gjeni aleate të fuqishëm për të mbrojtur një projekt që ka kundërshtitë e veta.



AKREPI

Nëse doni të merrni në dorë fatin tuaj sot mundohuni të qartësoni disa situata të dyshimta.



SHIGJETARI

Në ditët e shkuara keni bërë një gabim që do t'ju duhet pak kohë për ta rikuperuar. Gjithsesi do të dini si të veproni.



BRICJAPI

Sot një çështje financiare do t'ju shkaktojë shumë stres. Nëse ju kap paniku nuk do të arrini të zgjidhni gjë.



UJORI

Nëse keni mundësi për të mbaruar punë sot mos e neglizhoni. Koha nuk ju premtton për të gjitha projektet tuaja.



PESHQIT


Sot do të bëni zgjedhje që shkojnë në vendosni zakonisht. Do të rezultojnë mjaft produktivë.

Jonas Brothers reflektojnë ndarjen e tyre dhe ribashkimin e mundshëm



Jonas Brothers janë përzgjedhur si personazhet e kopertinës së revistës "Billboard" për këtë muaj, ku edhe e kanë dhënë intervistën e tyre në lidhje me historikun e grupit të tyre. "Të gjithë donim të krijonim diçka për veten dhe po mundoheshim ta shtynim përpara këtë ide. Po kalonim nëpër emocione dhe pa i

dhënë zemër punës. Mënyra se si komunikua me njëri-tjetrin nuk ishte e shëndetshme më", u shpreh Joe. Ndërkaq, Nick, në lidhje me idenë e ribashkimit të tyre më 2017-n, tha: "Është një magji ndryshe kur jemi bashkë, që unë nuk e prisja. Kështu që fillova t'i shpërndaj ca këngë të Jonas Brothersit në setin tim".



Rita Ora dhe Kygo performojnë bashkë për herë të parë para publikut

Këngëtarja me prejardhje nga Kosova, Rita Ora, para pak ditësh ka publikuar këngën më të re në bashkëpunim me Kygo. "Carry On" është kolona zanore e filmit "Decective Pikachu". Rita Ora të enjten në mbrëma për herë të

parë e ka performuar këtë këngë para publikut së bashku me Kygo. "Jam e lumtur me këtë performancë të këngës sonë me Kygo. Ndiem shumë mirë që performuam për herë të parë së bashku", ka shkruar Ora në "Instagram".

Selena Gomez: Dua të më duan për personin që jam



Selena Gomez njihet për historinë e dashurisë që kishte me Justin Bieberin si dhe me The Weeknd. Ylli i popit vijon të mbetet beqare dhe për të është e rëndësishme që të gjejë dikë i cili nuk e pëlqen vetëm për pamjen e jashtme. "Unë nuk i vlerësoj njerëzit

që më gjykojnë bazuar në paraqitjen time apo diçka e tillë. Unë thjesht mendoj se bota ka qaq shumë ekspozim ndaj gjithçkaje sa është bukur të vishesh dhe të ndihesh mirë. Thjesht, dua që dikush të më dojë për personin që jam. Kjo ka rëndësi për mua", ka thënë Gomez.

"Nightmare Alley" sjell DiCaprion në rolin e një mashtruesi



Leonardo DiCaprio do të jetë protagonist i filmit "Nightmare Alley", që do të ketë si regjisor fituesin e çmimit "Oscar", Guillermo del Toro. Meksikani, pas suksesit të "The Shape of Water", do të jetë regjisor dhe do ta firmosë edhe skenarin e këtij

filmi së bashku me Kim Morgan, ndërsa xhirimet pritet të nisnin në vjeshtën e ardhshme. Historia përqendrohet te një mashtrues i ri, rol të cilin e ka DiCaprio, që nis një marrëdhënie intime me një psikiatër, edhe më e korruptuar se ai.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Sot organizohet 'Xhudo për Paqe'

PEJË, 26 PRILL (ER) - Federata e Xhudos së Kosovës bashkë me Klubin e Xhudos "Ippon" në Pejë sot (e shtunë) do ta organizojnë Turneun Ndërkombëtar në Xhudo të cilin e kanë cilësuar "Xhudo për Paqe". Kështu ka bërë me dije, përmes një njoftimi në llogarinë e vet në "Facebook", trajneri Driton Kuka. Ai ka thënë se gara pritet të jetë e rëndësishme për të gjithë ata që pretendojnë arenën ndërkombëtare. Sipas tij, ekipi olimpiq në krye me Majlinda Kelmendin do të jetë i pranishëm për t'i takuar garuesit perspektivë dhe për t'i përkrahur të gjithë sportistët e rinj. Turneu do të zhvillohet në palestrën sportive "Karagaqi" në Pejë.



Federata e Xhudos së Kosovës & Klubi Xhudos "Ippon" Pejë
Organizor: Turneun ndërkombëtarë në Xhudo International Judo tournament

"JUDO FOR PEACE"
Turneu mbahet në Palestren Sportive "KARAGAQI" Pejë
Data: 27.04.2019 Ora: 11:00

KOSOVA - SHQIPËRIA - MALI I ZI - MAÇEDONIA - AUSTRIA - TURQIA - BOSNJE - ROMANI

Orari i ndeshjeve të javës së 29-të në IPKO Superligë

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Është caktuar orari i ndeshjeve për javën e 29 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll dhe për javën e 26 në

Ligën e Parë. Në elitë, tri ndeshje luhen këtë të shtunë, dy të dielën, kurse një përballje zhvillohet të hënën.

IPKO SUPERLIGA - JAVA E 29-TË

E shtunë, 27 prill ora 15:30

Feronikeli - Gjilani
Llapi - Drita
Ballkani - Ferizaj

E diel, 28 prill

Trepça '89 - Liria (ora 15:30)
Prishtina - Drenica (ora 19:00)

E hënë, 29 prill, ora 15:30

Flamurtari - KEK-u

LIGA E PARË - JAVA E 26-TË, ORA 15:30

E shtunë, 27. 04.2019

2 Korriku - Vushtrria
Ramiz Sadiku - Besa
Fushë Kosova - Kika
Onix - Trepça


E diel, 28.04.2019, ora 15:30

Vëllaznimi - Vitia
Dukagjini - Istogu
Arbëria - Vllaznia P
Drenasi - Bashkimi



Berisha: Po luftoj që të kthehem sa më shpejt

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Përfaqësuesi i Kosovës, Valon Berisha, shpreson që të rikthehet sa më parë në fushë, pa përfunduar sezoni 2018/19. Berisha u transferua verën e kaluar nga Salzburgu te Lazio, por mesfushori i Kosovës, Valon Berisha, ka vuajtur shumë, duke qëndruar i lënduar. "Ka qenë një vit i vështirë deri tani. Kam pasur shumë lëndime, por ende po qëndroj i fortë dhe po luftoj që të kthehem në fushë sa më shpejt një ose dy lojë para se të përfundojë sezoni. Jam këtu duke u munduar ta kthelloj mendjen. Do Zoti të kthehem shpejt", ka shkruar Berisha në "Instagram".



TREGU I FUTBOLLIT

PRISHTINË, 26 PRILL - Më të fundit nga bota e madhe e tregut të futbollit, ku ofertat apo zërat për transferime lojtarësh nuk mungojnë asnjëherë.

Leicesteri ofron 20 milionë euro për sulmuesin e Spalit

Leicesteri po ndjek me vëmendje sulmuesin e Spalit, Andrea Petagna dhe është gati të paguajë 20 milionë euro për ta marrë atë në Angli. Andrea Petagna po zhvillon një nga sezonet më të mira të karrierës së tij, pasi ka shkruar në kuotën e 14 golave deri tani.

Interi kërkon Sanchezin, por kiliani duhet t'i ulë pretendimet

Marotta ka një ide "të çmendur" për ta sjellë Alexis Sanchezin tek Interi dhe i ka propozuar kilianit një rol prej protagonistit në projektin e klubit. Megjithatë, më së pari duhet që Sanchezin ta pranojë uljen e rrogës, pasi Interi nuk i ofron 24 milionë euro në sezon.

Kloppi i mbyll derën Lorenzo Insignes

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, "i ka mbyllur dyert" kapitenit të Napolit, Lorenzo Insigne. "Është një futbollist shumë i mirë, por ka një kontratë afatgjatë me Napolin dhe nuk do të provojmë ta marrim", ka thënë gjermani.

Tottenhami gjen te Roma zëvendësuesin e Ericsonit

Klubi anglez i Tottenhamit ka hyrë në garë për t'i marrë shërbimet e mesfushorit të Romës, Nicolo Zaniolo. Ky i fundit shihet si zëvendësuesi ideal i danezit Ericson që pritet të largohet në verë.

Malcomi drejt largimit nga Barça, e duan në Itali dhe Angli


Sulmuesi brazilian Malcom pritet të largohet nga Barcelona në verë, pas vetëm një viti në Katalunjë. Për Malcomin ka oferta të shumta nga kampionati anglez (Arsenal dhe Tottenham) dhe nga ai italian (Milani dhe Interi).



Zabaleta: Guardiola do të qëndrojë te City për të fituar më shumë trofe

PRISHTINË, 26 PRILL - Pep Guardiola do të vazhdojë ta drejtojë Manchester Cityn përkundër spekulimeve për të ardhmen e tij. Kështu ka thënë Pablo Zabaleta.

Trajneri spanjoll është përmendur si zëvendësues i Massimiliano Allegrit te Juventus, mirëpo ai i kishte mohuar këto thashetheme në muajin e kaluar. 48-vjeçari është në Etihad Stadium që nga viti 2016 dhe ka arritur t'i fitojë tre trofetë e rëndësishëm, ndërkohë që



është sërish në garë për titullin e Premierligës dhe luan në finale të FA Cup kundër Watfordit.

Ish-lojtari i Cityt, Zabaleta, ka folur për "The Offside Rule Exclusives", ku ka thënë se Guardiola do ta vazhdojë qëndrimin në Etihad për shumë vite. "Jam i sigurt se do të qëndrojë te Manchester City, do të vazhdojë ta përmirësojë skuadrën dhe do të vazhdojë të fitojë trofe", ka thënë 34-vjeçari, i cili luan te West Ham Unitedi.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në
Shitjen 46

të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se:

Dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është: e mërkurë **08 maj 2019**, prej orës **10:00 - 12:00**,
në "Sallën e konferencave - Hotel Grand", Prishtinë.

*** Shënim: Njësitë në vijim janë tërhequr nga Shitja e aseteve 46:**

Njësia 27: KB Leposaviq Toka në Sllatinë

Njësia 28: KB Leposaviq Parcelat 1329-0; 1330-0 dhe 1355-0 në Popovce

Njësia 29: KB Leposaviq Parcela 01526-0 në Popovce


Njësia 31: Obuça Lokali në Mitrovicën Veriore

Njësia 63: Ratar Tokë Bujqësore Prishtinë IX

Si duhet të përgatitet oferta:

OFERTA E JUAJ DUHET TË PËRMBAJ 3 PLIKO (ZARFE).

